



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Statistikat e PRODCOM-it (2014)



AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Statistikat e PRODCOM-it (2014)



AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Botuesi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)
Data e botimit: Shkurt, 2016
© : *Agjencia e Statistikave të Kosovës*
Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.
Informata të shumta janë në dispozicion në internet,
ku mund të qaseni përmes veb-faqes së ASK-së
në internet: <http://ask.rks-gov.net>

P a r a t h ë n i e

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka përgatitur publikimin e rezultateve të Statistikave të prodhimit industrial apo PRODCOM - it për vitin 2014.

Duke filluar nga viti 2014, e këndej ky hulumtim është pjesë përbërëse e Programit statistikor të ASK - së dhe bazohet në deklaratimet e ndërmarrjeve. Ky hulumtim do të publikohet në baza të rregullta vjetore.

Rezultatet e këtij hulumtimi paraqesin ecurinë e prodhimit industrial në ekonominë e Kosovës. Gjithashtu këto rezultate përdoren për nevoja të përpilimit të llogarive kombëtare dhe janë burim i rëndësishëm në përpilimin e Bruto Produktit Vendor me qasjen e prodhimit dhe shpenzimeve në baza tremujore.

Publikimi vjetor mbi statistikave të PRODCOM - it përmban të dhëna gjithpërfshirëse dhe të detajuara vjetore nga fusha e statistikave të prodhimit industrial. Të dhënat e prezentuara janë grumbulluar përmes hulumtimit vjetor PRODCOM mbi prodhimin industrial PRODCOM për 2014.

Ky publikim mund t'u nënshtrohet korigjimeve eventuale për shkak të aplikimit të metodologjive të reja sipas EUROSTAT-it.

Publikimin e përgaditën:

Ilir T. Berisha - Drejtor i departamentit

Ismail Sahiti – Shef i divizionit,

Hysni Elshani - Shef i sektorit,

Muhamet Kastrati - Specialist i TI - së për RSB,

Valdete Navakazi - Zyrtare,

Luljeta Krasniqi - Zyrtare

(E - mail: economic@rks-gov.net)

Shkurt, 2016

Kryeshef Ekzekutiv i ASK-së,

z. Isa Krasniqi

Simbolet dhe shkurtesat

ASK	-	Agjencia e Statistikave të Kosovës
KVE	-	Klasifikimi i veprimtarive ekonomike
ATK	-	Administrata Tatimore e Kosovës
ARBK	-	Agjencioni i Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë
RSB	-	Regjistri Statistikor i Bizneseve
PRODCOM	-	Statistikat e prodhimit industrial

Simbolet

:	-	Mungojnë të dhënat
n/a	-	Nuk aplikohet

Përmbajtja

	Faqe
1 Objektivi, metodologjia dhe shtrirja e anketës	5
2 Definicione, përkufizime dhe treguesit themelorë	6
3 Treguesit themelorë	8
Tabela 1. Numri i të punësuarve, kapaciteti i prodhimit të realizuar dhe shitjet e realizuara në kuadër të sektorit B, gjatë vitit 2014	8
Tabela 2. Numri i të punësuarve, kapaciteti i prodhimit të realizuar dhe shitjet e realizuara në kuadër të sektorit C, gjatë vitit 2014	9
Tabela 3. Numri i të punësuarve, kapaciteti i prodhimit të realizuar dhe shitjet e realizuara në kuadër të sektorit D, gjatë vitit 2014	11
Tabela 4. Numri i të punësuarve, kapaciteti i prodhimit të realizuar dhe shitjet e realizuara në kuadër të sektorit E, gjatë vitit 2014	11
Tabela 5. Struktura e të punësuarve, kapaciteti i prodhimit të realizuar dhe shitjet e realizuara për sektorët industriale gjatë vitit 2014	11

1 Objektivi, metodologjia dhe shtrirja e anketës

1.1. Objektivi

Objekt i përfshirjes së PRODCOM-it dhe njësi raportuese të PRODCOM janë të gjitha shoqëritë tregtare dhe persona tjerë juridik me mbi 10 të punësuar, të cilat janë marrë me aktivitet të prodhimit industriale apo kanë ushtruar shërbime industriale për nevoja vetanake apo në bazë të kontratës, gjatë vitit referues sipas definicioneve të sektorëve industriale B, C, D dhe E (vetëm dega 36) NVE së 2014. Anketa synon t'i plotësojë kërkesat për informacione më të plota statistikore në kushtet e ekonomisë së tregut dhe ofron të dhëna mbi aktivitetet ekonomike të ndërmarrjeve në sektorin e prodhimit industrial.

1.2. Metodologjia dhe shtrirja e anketës

Ky hulumtim PRODCOM realizohet me qëllim të sigurimit të të dhënave të detajuara mbi tregun vendor, t'i harmonizojë me të dhënat e tregtisë së jashtme dhe ashtu të mundësojë krahasimin e tregut vendor me tregun ndërkombëtar në nivel të detajuar të produkteve/mallrave individuale, çka edhe është qëllimi i hulumtimit të PRODCOM të BE-së me të cilin është i harmonizuar. Të gjitha të dhënat në nivel të produkteve janë mbledhur sipas Listës së PRODCOM -2014 të BE, e cila është pjesë përbërëse e Rregullores për PRODCOM të BE-së.

Ky publikim përmban të dhëna të detajuara mbi prodhimin industrial në nivel të vendit. Nocioni apo termi "industri" është definuar me prodhimet (dhe shërbimet) nga sektori B, C, D dhe E (vetëm grupi 36) sipas KVE Rev.2. (Rregullorja 02/2011). Ky definicion mbi industrinë është i harmonizuar me definicionin i cili shfrytëzohet në BE mbi statistikatat e PRODCOM-it.

Burimet dhe metodat e grumbullimit të të dhënave : Burim i të gjitha të dhënave të publikuara në këtë publikim janë rezultat i hulumtimit statistikor PRODCOM mbi prodhimin industrial për vitin 2014. Është realizuar nga ana e ASK-së në bazë të ligjit mbi statistikatat zyrtare, Planit vjetor të ASK-së, mbi realizimin e hulumtimeve statistikore për vitin 2015 dhe standardeve statistikore të hulumtimit mbi statistikatat e industrisë në 2014 - PRODCOM.

Objekt i hulumtimit të PRODCOM - it për 2014 është prodhimi i mundshëm dhe i realizuar i produkteve industriale, sasia dhe vlera e shitur e prodhimit industrial.

Nuk përfshihet prodhimi i cili është shfrytëzuar apo do të shfrytëzohet për përpunim të mëtejshëm në njësi lokale të cilat i përkasin të njëjtit biznes (njësi raportuese). Përfshin prodhimin e realizuar për nevoja vetanake si dhe prodhimin në bazë të kontratës me porositësin. Të dhënat mbi prodhimin janë prezentuar në nivel të aktivitetve ekonomike sipas KVE 2 si dhe listës së produkteve, në bazë të përqindjes. Të

dhënat për përpunim janë grumbulluar në mbarë teritorin e vendit. Të gjitha të dhënat e PRODCOM - it i referohen periudhës njëvjeqare duke filluar nga 1.01.2014 deri më 31.12.2014. Janë prezentuar vetëm të dhënat mbi prodhimin e realizuar mbrenda teritorit të Republikës së Kosovës.

Nuk është përfshirë prodhimi i cili është realizuar jashtë teritorit të Republikës së Kosovës në emër të njësisive lokale apo bizneseve.

Në vazhdim të tekstit janë dhënë shpjegime metodologjike të posaçme dhe u sugjerohen të gjithë shfrytëzuesve si një mjet i domosdoshëm për interpretim korekt të të dhënave dhe shfrytëzimin e tyre.

Treguesit e PRODCOM-it mbi prodhimin industrial.

1.3. Procedurat e mbledhjes (grumbullimit) së të dhënave

Për krijimin (përcaktimin) e kornizës së mostrës janë shfrytëzuar të dhënat nga regjistri statistikor i bizneseve. Të gjitha ndërmarrjet që kanë deklaruar njërin nga tatimet gjatë viteve referuese për vitet paraprake janë konsideruar aktive. Përzgjedhja e mostrës është bërë në bazë të kriterit ku janë përfshirë të gjitha ndërmarrjet që përfaqësojnë 80% të qarkullimit për aktivitetin përkatës të KVE Rev2.

2 Definicione, përkufizime dhe treguesit themelorë

2.1. Definicione dhe përkufizime

PRODCOM është emërtim për statistika prodhuese mbi prodhimin industrial të BE-së të definuar me Regulloren No.3924/91. Shkurtesa është derivuar nga emërtimi në gjuhën frengje "Production Communautaire" (Prodhimi në Bashkësi).

Lista e PRODCOM - është një listë e produkteve, të mirave dhe shërbimeve të cekura në emërtimet e hulumtimit të PRODCOM. Lista përmban 3 888 emërtime obligative të cilat në parim shfrytëzohen për kompilim të statistikave prodhuese të BE-së.

Produkti-prodhimi

Prodhimi është si rezultat i një aktiviteti ekonomik. Shfrytëzohet si nocion për produktet të cilat kanë dimenzion fizik edhe për shërbimet. Sipas konceptit të hulumtimit PRODCOM-it sipas listës së produkteve të BE-së. Sipas nocionit të prodhimit të gatshëm konsiderohet çdo produkt i cili gjatë procesit të prodhimit industrial ka aritur një nivel të caktuar të përpunimit, dhe sipas listës së produkteve është e kodifikuar me një kod të veçant.

Konceptet dhe definicionet e shfrytzuara në hulumtimin e PRODCOM-it të Republikës së Kosovës janë të harmonizuara me hulumtimin e PRODCOM - it të BE - së.

Japin shpjegime shtesë të disa nocioneve të cilat shfrytzojnë për statistika të PRODCOM-it në kuadër të këtyre shpjegimeve metodologjike dhe nuk kanë kuptim definitiv të domethënies së këtyre fjalëve dhe në kontekst tjetër mund të kenë kuptim tjetër. Qëllimi është vetëm të ndihmojnë shfrytzesit e të dhënave të PRODCOM - it në interpretim korekt të tyre.

Ndërmarrja është njësi më e vogël e kombinimit të njësisë legale me njësinë e prodhimit të produkteve ose shërbimeve e cila ka pavarësi në vendim-marrje, sidomos për përdorimin e burimeve të saj materiale e monetare. Një ndërmarrje mund të ushtrojë një ose disa aktivitete ekonomike.

Ndërmarrje aktive – konsiderohen vetëm ato ndërmarrje që kanë deklaruar njërin nga tatimet apo ndonjë të punësuar për vitin referues. Ndërmarrja është njësi më e vogël e kombinimit të njësisë legale me njësinë e prodhimit të produkteve ose shërbimeve e cila ka pavarësi në vendim-marrje, sidomos për përdorimin e burimeve të saj materiale e monetare. Një ndërmarrje mund të ushtrojë një ose disa aktivitete ekonomike.

Ndërmarrje aktive – konsiderohen vetëm ato ndërmarrje që kanë deklaruar njërin nga tatimet apo ndonjë të punësuar për vitin referues.

Njësi statistikore janë ndërmarrjet industriale si dhe njësite lokale të ndërmarrjeve joindustriale të cilat merren me prodhimin e produkteve të definuar sipas listës së PRODCOM -it.

Njësitë statistikore apo pjesët e tyre të cilat "fizikisht" janë jashtë teritorit të Republikës së Kosovës, nuk janë të përfshira. Përfshirja e njësive statistikore është bërë në baze të Regjistrimit statistikor të bizneseve, i cili azhurohet në baza vjetore. Kriterium i veçant për përfshirje në hulumtimin e PRODCOM - it është që secila klasë e industrisë (nga 05.10 deri 36.00) në KVE 2014 të mundësojë përfshirje të mjaftueshme të njësive statistikore me pjesmarrje me së pakut 90% të vlerës së shtuar bruto të secilës klasë të industrisë. Nëse ai kriter nuk plotësohet për ndonjë klasë të KVE 2014, atëherë përfshirja zgjerohet edhe njësi statistikore me më pakë se 10 të punësuar.

3 Treguesit themelorë

Tabela 1. Numri i të punësuarve, kapaciteti i prodhimit të realizuar dhe shitjet e realizuara në kuadër të sektorit B, gjatë vitit 2014

Sektori	Grupi	Aktiviteti ekonomik	Numri i të Punsuarve	Sasia e Prodhuar	Vlera në Euro e	Sasia totale e shitur	Vlera totale e shitur
B	051	Nxjerrja e qymyrit të fortë	0,43	0,02	0,19	0,01	0,19
	072	Nxjerrja e mineraleve jo-metalore	9,13	0,00	0,25	0,00	0,20
	081	Nxjerrja e gurit, rërës dhe argjilës	1,08	0,36	0,90	0,19	0,88
	089	Minierat dhe guroret (Industria nxjerrëse) p.k.t.	0,05	0,00	0,01	0,00	0,01
	099	Veprimtaritë mbështetëse për nxjerrjen e produkteve të tjera nga nëntoka	0,02	0,00	0,00	0,00	0,00

%

Tabela 2. Numri i të punësuarve, kapaciteti i prodhimit të realizuar dhe shitjet e realizuara në kuadër të sektorit C, gjatë vitit 2014

%

Sektori	Grupi	Aktiviteti ekonomik	Numri i të Punsuarve	Sasia e Prodhuar	Vlera në Euro e Prodhuar	Sasia totale e shitur	Vlera totale e shitur
C	101	Përpunimi dhe konservimi (ruajtja) i mishit dhe produkteve me bazë mishi	2,88	24,23	73,63	12,90	74,31
	103	Përpunimi dhe konservimi i frutave dhe perimeve	3,71	0,23	0,19	0,12	0,30
	104	Përpunimi i vajrave dhe yndyrnave bimore dhe shtazore	0,27	0,48	1,51	0,27	1,47
	105	Prodhimi i produkteve të qumështit	1,74	1,13	0,37	0,71	0,27
	106	Përpunimi i produkteve të drithrave, niseshtes dhe produkteve të niseshtes	3,20	7,05	0,50	2,30	0,61
	107	Prodhimi i produkteve të bukës, ëmbëlsirave, makaronave	9,29	15,95	1,26	25,78	1,55
	108	Prodhimi i produkteve të tjera ushqimore	1,28	0,58	0,24	0,32	0,24
	110	Prodhimi i pijeve	2,61	15,02	2,63	7,37	1,96
	131	Përgatitja dhe thurja e fijeve të tekstilit	0,02	0,00	0,00	0,00	0,00
	132	Endja e tekstilit	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00
	133	Proceset përfundimtare të përpunimit të tekstilit	0,51	0,01	0,02	0,00	0,02
	139	Prodhimi i tekstileve të tjera	0,32	0,21	0,06	0,12	0,06
	141	Prodhimi i veshjeve, përveç veshjeve të gëzofit	1,71	0,04	0,06	0,02	0,06
	143	Prodhimi i rrobave të thurura me grep	0,06	0,10	0,01	0,05	0,01
	151	Tanini dhe regjia e lëkurës, prodhimi i valixheve, çantave , takëmeve të kuajve dhe takëmeve të tjerë, veshja dhe ngjyrosja e gëzofit	0,13	0,01	0,01	0,01	0,01
	152	Prodhimi i këpucëve	1,24	0,03	0,13	0,01	0,12
	161	Sharrimi i drurit dhe zdrukhtaria	1,14	0,07	0,19	0,10	0,17
	162	Prodhimi i produkteve të drurit, tapës, kashtës dhe materjaleve të gërshetuara - thurëse	3,96	0,12	0,46	0,07	0,55
	171	Prodhimi i brumit të letrës, letrës dhe kartonit	0,04	0,07	0,08	0,08	0,08
	172	Prodhimi i artikujve të letrës dhe kartonit	0,52	2,36	0,17	1,23	0,17
	181	Veprimtarit e shtypjes (printimit) dhe shërbimet e lidhura me shtypjen	1,75	1,34	0,07	0,33	0,17
	192	Përpunimi i produkteve të rafinuara të naftës	0,04	0,00	0,23	0,00	0,22
	201	Prodhimin i produkteve kimike bazë, plehrave kimike dhe komponimeve të azotit, plastikave dhe gomës sintetike në formë primare	0,62	0,21	0,27	0,11	0,23
	202	Prodhimi i pesticideve dhe produkteve të tjera agrokimike	0,01	0,00	0,00	0,00	0,00
	203	Prodhimi i ngjyrave, llaqeve dhe shtresave të ngjajshme, ngjyrën e printimit dhe mastikës	0,60	2,23	0,59	1,21	0,61
	204	Prodhimi i sapunit dhe detergjentëve, preparatave të pastrimit dhe lustrimit, parfumeve dhe preparateve të toaletit	0,09	0,94	0,12	0,51	0,11
205	Prodhimi i produkteve tjera kimike	0,17	0,47	0,03	0,25	0,03	
206	Prodhimi i fibrave sintetike dhe artificialë	0,12	0,01	0,01	0,00	0,01	

Tabela 2. Numri i të punësuarve, kapaciteti i prodhimit të realizuar dhe shitjet e realizuara në kuadër të sektorit C, gjatë vitit 2014

(vazhdim)

%

Sektori	Grupi	Aktiviteti ekonomik	Numri i të Punsuarve	Sasia e Prodhuar	Vlera në Euro e Prodhuar	Sasia totale e shitur	Vlera totale e shitur
C	221	Prodhimi i produkteve të gomës	1,95	0,26	0,27	0,08	0,19
	222	Prodhimi i produkteve të plastikës	7,25	4,73	1,89	1,92	1,77
	231	Prodhimi i qelqit dhe produkteve prej qelqit	0,40	0,02	0,05	0,01	0,05
	233	Prodhimi i materialeve të ndërtimit prej argjilës	0,84	4,03	0,31	2,24	0,30
	234	Prodhimi i produkteve tjerë nga porcelani dhe qeramika	0,02	0,00	0,00	0,00	0,00
	235	Prodhimi i çimentos, gëlqerës dhe llaçit	0,10	0,17	0,12	0,09	0,12
	236	Prodhimi i artikujve të betonit, çimentos dhe llaçit	7,53	2,07	4,72	1,26	4,62
	237	Thyerja e gurit, dhënia e formës dhe finicioni	1,78	0,52	0,62	0,22	0,62
	239	Prodhimi i produkteve gërryese dhe i produkteve të mineraleve jo metalike p.k.t.	0,20	0,23	0,02	0,11	0,02
	241	Prodhimi i hekurit dhe çelikut bazë ,si dhe ferrolegurave	1,95	0,13	4,43	0,12	4,48
	243	Prodhimi i produkteve të tjera nga përpunimi i parë i çelikut	0,22	0,02	0,02	0,01	0,02
	244	Prodhimi i metaleve të çmuar dhe metaleve jo-ferrike	0,10	0,01	0,02	0,01	0,02
	245	Derdhja (fonderia) e metaleve	0,13	0,01	0,02	0,00	0,02
	251	Prodhimi i produkteve të konstrukcioneve metalike	4,03	3,62	1,21	34,91	1,26
	252	Prodhimi i tankerëve, rezervarëve dhe kontejnerëve të metalit	0,01	0,00	0,01	0,00	0,01
	255	Farkimi, presimi, stampimi dhe palosja rrethore e metaleve, pluhuri metalurgjik	0,23	0,01	0,04	0,01	0,07
	256	Trajtimi dhe veshja e metaleve; përpunimi mekanik	0,59	0,15	0,36	0,08	0,36
	257	Prodhimi i takëmeve të kuzhinës, mjeteve dhe pajisjeve të përgjithshme metalike	0,01	0,00	0,00	0,00	0,00
	259	Prodhimi i produkteve të tjera prej metalit	0,44	0,11	0,07	0,06	0,07
	262	Prodhimi i kompjuterëve dhe pajisjeve periferike	0,01	0,00	0,01	0,00	0,00
	266	Prodhimi i pajisjeve për rrezatim, elektromjekësore dhe elektroshtëpiake	0,01	0,00	0,00	0,00	0,00
	273	Prodhimi i telava dhe kabllove të izoluar	0,02	0,16	0,05	0,09	0,05
	275	Prodhimi i pajisjeve shtëpiake	0,13	0,00	0,01	0,00	0,01
	279	Prodhimi i pajisjeve të tjera elektrike	0,03	0,00	0,00	0,00	0,00
	282	Prodhimi i makinerive të tjera për qëllime të përgjithëshme	0,13	0,00	0,06	0,00	0,07
	289	Prodhimi i makinerive të tjera për qëllime të veçanta	0,02	0,00	0,01	0,00	0,01
	310	Prodhimi i mobileve	7,95	0,07	0,57	0,03	0,69
	321	Prodhimi i stolive të çmuara (argjentarisë), bizhuterive dhe artikujve të ngjashëm me to	0,03	0,00	0,01	0,00	0,01
	332	Instalimi i makinerive dhe pajisjeve industriale	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00

Tabela 3. Numri i të punësuarve, kapaciteti i prodhimit të realizuar dhe shitjet e realizuara në kuadër të sektorit D, gjatë vitit 2014

%

Sektori	Grupi	Aktiviteti ekonomik	Numri i të Punsuarve	Sasia e Prodhuar	Vlera në Euro e Prodhuar	Sasia totale e shitur	Vlera totale e shitur
D	351	Prodhimi, transmetimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike	96,30	:	97,8	:	98,28
	352	Prodhimi i gazit, shpërndarja e lëndëve të gazta nëpërmjet tubacioneve	0,06	:	:	:	0,37
	353	Furnizimi me avull dhe ajër të kondicionuar	3,64	:	2,2	:	1,35

Tabela 4. Numri i të punësuarve, kapaciteti i prodhimit të realizuar dhe shitjet e realizuara në kuadër të sektorit E, gjatë vitit 2014

%

Sektori	Grupi	Aktiviteti ekonomik	Numri i të Punsuarve	Sasia e Prodhuar	Vlera në Euro e Prodhuar	Sasia totale e shitur	Vlera totale e shitur
E	360	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	6,89	10,32	0,91	4,62	0,54

Tabela 5. Struktura e të punësuarve, kapaciteti i prodhimit të realizuar dhe shitjet e realizuara për sektorët industriale gjatë vitit 2014

%

Sektori	Ndarja	Aktiviteti ekonomik	Numri i të Punsuarve	Sasia e Prodhuar	Vlera në Euro e Prodhuar	Sasia totale e shitur	Vlera totale e shitur
B	05-09	Industri nxjerrëse (Minierat dhe guroret)	9,83	0,39	1,30	0,20	1,12
C	10-33	Industri përpunuese	68,03	89,28	93,83	95,17	85,89
D	35	Furnizimi me rryme, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	15,82	0,00	3,99	0,00	12,52
E	36-39	Furnizimi me ujë, veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave	6,32	10,32	0,87	4,62	0,47

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

338.242(496.51)“2014”(048)

Statistikat e PRODCOM-it (2014) / Publikimin e përgatitën Ilir
T. Berisha...[et al.] – Prishtinë : Agjencia e Statistikave të Kosovës,
2016. - 16 f. : ilustr. me ngjyra ; 28 cm. – (Seria 3: Statistikat
Ekonomike)

Parathënie / Isa Krasniqi : f. [1]

1. Berisha, Ilir T.

ISBN 978-9951-22-252-5

Agjencia e Statistikave të Kosovës

përshkrim i shkurtër

Agjencia e statistikave të Kosovës është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

Agjencia e Statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Plani zhvillimor strategjik 2009-2013 është në implementim afatmesëm për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë strukturë organizative: **Departamentet prodhuese;** (Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit, dhe Departamenti i statistikave sociale. **Departamentet mbështetëse;** (Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës. **Ne kuadër të Agjencionit vepron edhe; Zyrat Rajonale;** Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj

Numri i të punësuarve dhe buxheti akoma janë të limituar. Të punësuar janë gjithsej 139 punëtorë, prej tyre, 104 (74,8%) në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 35 (25,2%), Agjencioni ka këtë strukturë kualifikuese, 70,5% me shkollim universitar ndërsa 29,5% me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikave të shteteve në rajon.

Agjencia e Statistikave të Kosovës mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njërive raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Kemi realizuar me sukses në vitin 2011 projektin e Regjistrimit të Popullsisë Ekonomive Familjar dhe banesave, i cili regjistrim nuk është realizuar që nga viti 1981. Rezultatet e fituara nga ky regjistrim do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

Misioni i Agjencionit; të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë, bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- o **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- o **Telefoni:** +381 (0) 38 200 31 129
Kryeshafi Ekzekutiv: +381 (0) 38 200 31 112
- o **Fax:** +381 (0) 38 235 033
- o **E-mail:** economic@rks-gov.net
- o **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>

ISBN 978-9951-22-252-5



9 789951 222525